

**GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE**, Gjyqtari Ragip Kadriu  
ne qeshtjen juridike te paditesit; nga Rr. nr.  
kunder te naditurve; dhe qe te dy nga Mitrovica, shitorja  
baza e kontestit; lirim dhe dorzimin e lokalit afarist, ,  
vlere e lendes se kontestit 1.000,00 Euro, pas mbajtjes se shqyrtimit me dt. 17.04.2014.  
jep.,

## A K T G J Y K I M

**I- APROVOHET** kerkespadia e paditesit; nga Mitrovica dhe  
**DETYROHEN** te paditurit dhe qe ta lirojne nga te gjitha  
sendet dhe njerzit, lokalit afarist i cili gjendet ne pjesen te ne  
Rr. ne siperfaqe 73m2, nga te cilat 33,12m2 jane lokal dhe 39,88m2  
jane podrum dhe ashtu te zbrazet ti dorzojn ne shfrytzim dhe disponim te lire paditesit,  
ne afati prej 15 diteve nga dita e pranimit te ketije aktgjykimi nen kercnimin e  
ekzekutimit te dhunshem..

**II - Secila pale i bart shpenzimet e veta te procedures kontestimore.**

### A r s y e t i m

Paditesi ka parashtruar padi kunder te paditurive per lirim dhe dorzimin e  
lokalit afarist, duke theksuar se me dt. 27.06.2012 ne cilsit te blesit ka lidhur kontrat mbi  
shitjen dhe bartjen e pronesise me Agjencionin Kosovar te Privatizimit si shites

Lende e kesaje kontrate eshte palujtshmeria-lokali afarist i cekur ne dispozitiv te  
ketije aktgjykimi sipas kontrates nr. 372 dt. 27.06.2012 .

Megjithate paditesi edhe pse eshte bere pronar i ligjshem i lokalit te lartcekur i  
njejti eshte i penguar qe te hyje ne posedim te ketije lokali nga te paditurit te cilet e  
ushtrojne veprimtarin tregtare nen firmen "Paki".

Paditesi disa her ka kerkuar nga te paditurit qe ti lrojn lokalit ne fjale por te  
njejtit refuzojn.

Ne fjalen perfundimtare i propozon gjykates qe padin dhe kerkespadin ta aprovoi  
si te bazuar.

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoi.

Gjykata seancën e shqyrtimit kryesor e mbajti ne mungese te paditurve, konform nen 423.4 te LPK.

Gjykata ne séance e shqyrtimit kryesor zhvilloi provat e propozuara dhe te nevojshme dhe pase administrimit dhe vlersimit te te njejtave ne kuptim te nen. 8 te LPK, erdhi ne perfundim se duhet vendosur si ne dispozitiv te ketije aktgjykimi.

Gjykata ne procedure e provave lexoi; Kontraten Nr. 372 dt. 27.06.2012 mbi shitjen dhe bartjen e prones, si dh formularin per pranim dorzim dt.02.07.2012, dhe konstatoi kete gjendje faktike.

Nga Kontrata e sipercekur mbi shitjen dhe bartjen e prones, konstatohet se paditesi eshet pronar i palujtshmerise tani lendore.

Nga thenjet e paditesit rrjedhe se kete palujtshmeri tani e shfrytzojne te paditurit pa baze juridike.

Ne nje gjendje te ketille faktike gjykata kerkespadin e paditesit e aprovoi si te bazuar, konform nen 93 te Ligjit per pronesine dhe te drejtat tjera sendore, Ligji Nr. 03/l-154., ku eshte percaktuar se; Pronari munde te kerkoje kthimin e sendit te caktuar prej secilit i cili nuk ka te drejt posedimi.

Duke bere interpretimin e kesaje dispozite ligjore lidhur me mbrojtjen e pronesise jep te kuptohet se pronari duhet te provoi se ne sendin te cilin e kerkon ti kthehet ka te drejten e pronesise, si dhe qe sendi gjendet ne pushtetin faktik te paditurit.

Nga te cekurat rrjedhe se kur kemi te bejme me sendet e palujtshme, atehere shume me lehte argumentohet e drejta e pronesise, qka ne rastin konkret nga Kontrata per shitjen dhe bartjen e prones se sipercekur vertetohet se paditesi eshte titular i kesaje palujtshmerie tani lendore.

Ne nje gjendje te ketille faktike gjykata konstatoi se; pronar i kesaje palujtshmerie eshet paditesi dhe se kjo palujtshmeri tani gjendet ne pushtetin faktik te paditurve te cilet kete palujtshmeri e mbajne pa baze ligjore, prandaj vendosi si ne dispozitiv te ketije aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedures kontestimore bazohet ne baze te nen.450 te LPK.

Nga si u tha me lart u vendos sin e dispozitiv te ketij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE,  
C.nr.229/2012 dt. 17.04.2014.,

**Gjyqtari,**  
Ragip Kadriu,

KESHILLE JURIDIKE, Kunder ketij aktgjykimi, munde te ushtrohet ankese  
ne afat prej 15, diteve, nga dita e pranimit, Gjykates  
se Apelit te Kosoves e nepermjet te kesaje gjykate.